



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0538

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Krzetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) DWH-KOSOVA SH.P.K., kundër "Mosekzekutimi i vendimit të OSHP-së të Komuna e Gjakovës" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me instrument GPS" me numër të prokurimit 632-22-7865-1-2-1, me 03/10/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE DWH-KOSOVA SH.P.K. me nr. 2023/0538, e datës 01/08/2023, kurse vendimi i AK Komuna e Gjakovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me instrument GPS" me numër të prokurimit 632-22-7865-1-2-1 anulohet, ndërkaj aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues- Komuna e Gjakovës të zbatojë vendimin e OSHP-së me numër: PSh. nr. 2023/0188 të datës 13.06.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS" me numër të prokurimit 632-22-7865-1-2-1
3. URDHËROHET Autoriteti Kontraktues- Komuna e Gjakovës, që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në dhe operatorin ekonomik OE DWH-KOSOVA SH.P.K. lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së: PSh. nr. 2023/0188 të datës 13.06.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS" me numër të prokurimit 632-22-7865-1-2-1
4. Mos respektimi i kësaj urdhërese në afat prej pesë ditësh kalendarike do ta detyrojë Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe në të njëjtën kohë të kërkojë nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK-së /Komuna e Gjakovës, konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.
5. Me qenë se ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Me datë 03.08.2022, Komuna e Gjakovës nga cilësia e saj si AK ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me instrument GPS" me numër të prokurimit 632-22-7865-1-2-1.

Me datën 11.07.2023 autoriteti kontraktues ka publikuar njoftimin për anulim të kontratës në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Kundër vendimit për anulim me datën 27.07.2023 në AK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim OE "DWH Kosova" të cilën me vendim me datën 31. 07. 2023, AK e ka refuzuar.

Si palë e pakënaqur me vendimin për refuzim të AK-së, me datë 01.08.2023, OE "DWH Kosova" ka ngritur ankesë në OSHP me numër 2023/0538 (numër protokolli).

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak

OSHP konstatoi se ankesat në rastin konkret, janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e kane statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesat përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Paneli Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 14.08.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues të pranohet si pjesërisht e bazuar;
- Te rivlerësohet aktiviteti i prokurimit

*(a) Pohimet ankimore të OE "DWH Kosova" dhe
sqarimet e ekspertit shqyrtues*

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Përgjigje në pretendimet ankimore

Për këtë aktivitet të prokurimit është parashtruar disa here nga i njëjti OE ankues, ku në secilin rast ankesa e OE DWH Kosova është aprovuar si e bazuar.

Edhe tani arsyet e eliminimit dhe pretendimet ankimore të OE ankues, kanë qenë objekt i shqyrtimit disa here në OSHP dhe konsiderojmë se janë çështje e gjykuar.

AK edhe pas rivlerësimit të ofertave me rastin eliminimit të OE ankues ka ngritur çështje për të cilat OSHP veç ka vendosur përmes vendimeve nr.458/20, vendimit nr.1021/20, vendimi nr.95/21, vendimi nr.380/22, vendimi nr.188/23.

Konsiderojmë se kjo përbën shkelje të rëndë të LPP-së sipas rregullores për prokurim publik nr.001/2022 neni 97.1 pika "h"- Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimet ankimore të OE ankues janë të bazuara.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe mbështet rekomandimin e ekspertit që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerëson se Autoriteti Kontraktues - Komuna e Gjakovës, zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe komisioni i ri-vlerësimit gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk e ka marr për bazë fare Vendimet e OSHP, e sidomos vendimin e OSHP nr. 2023/0188 të datës 13.06.2023, andaj, ankesa e OE ankues përsëritet për herë të dytë dhe se ankesa konform Rregullores së Punës së OSHP-së konkretisht neni 16.3 të trajtohet si “Res Judicata”.

Po ashtu neni 105 paragrafi 2.16 i LPP-së sqaron: “Në rastet e përsëritura me të njëjtat pretendime ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, në rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i Panelit Shqyrtues i trajton si çështje të gjykuara “res judicata”.

Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin nr.2023/0188, dihet mirë se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim.

Andaj, Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Gjakovës që në tërësi të zbatohet vendimi i PSH nr.2023/0188, ku për këtë vendim ka pasur edhe superekspertizë nga eksperti shqyrtues teknik i angazhuar nga OSHP. Andaj, OSHP-ja urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) - Komunën e Gjakovës që të ndërmerr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të LPP-së dhe njëkohësisht të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë licencën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - Komuna e Gjakovës në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues konform nenit 117 dhe nenit 105 paragrafi 2.10 të LPP-së, dhe në bazë të dëshmive të paraqitura më lartë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - DWH-KOSOVA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: